

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Krimeve të Rënda në përbërje të trupit gjykues **Nikollë Komani**, Kryetar i trupit gjykues, Manduhije Sylja dhe Lulëzim Paçarizi, anëtar të trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. L. nga Gjakova, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I. nr. 267/2015 të datës 05.01.2015, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësor më datë **22.04.2015, 08.05.2015, 18.05.2015, 10.06.2015, 19.06.2015** dhe **30.06.2015**, në prezencën e Prokurorit Agron Matjani, të akuzuarit A. L., mbrojtësi të tij N. D. avokat në Gjakovë, me datë **03.07.2015** mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. L.**, i biri i H. dhe i S., e gjinisë M., i lindur më... në Gjakovë, ku dhe jeton rruga..., i martuar atë i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer fakultetin, inspektor i bujqësisë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Bazuar në nenin 364 para. 1 pika 1.3 të KPP-së:

LIROHET NGA AKUZA

Se i akuzuari gjatë periudhës prej vitit 2010 e gjerë në vitin 2014 në cilësinë e inspektorit të bujqësisë në Komunën e Gjakovës, ka përfutuar në mënyrë të kundërligjshme dobinë pasurore, nga i dëmtuari M. N. pronar i lokalit afarist-biznesor “H. E.” në atë mënyrë që gjatë kontrollit që i ka bërë i akuzuari të dëmtuarit e ka obliguar që të pajiset me certifikatën për ofrimin e shërbimeve me pije alkoolike gjë që për këtë është dashur ti paguaj taksën prej 500,00 € në vit, kështu që i akuzuari ka marrë para kesh në dorë kinse do shkoj për ti paguar në emër të biznesit të dëmtuarit, por që këtë gjë nuk e ka bërë dhe nganjëherë e ka bërë pagesën pjesërisht, dhe nuk e ka pajisur me certifikatën e tillë, me çka do të kishte kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.

I dëmtuari M. N. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me Aktakuzën PP/I. nr. 267/2014 të datës 05.01.2015, ka akuzuar A. L. nga Gjakova, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.

Prokurori **Agron Matjani** në shqyrtimin gjyqësor të datës 22.04.2015, në fjalën e tij hyrëse ka deklaruar se aktakuza e ngritur kundër të akuzuarit A. L. nga Gjakova për shkak të veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së, përmban prova të mjaftueshme që dëshmojnë që i akuzuari ka keqpërdorë detyrën e tij zyrtare si inspektor i bujqësisë, ashtu që nga i dëmtuari M. N., pronar i hotelit "E." në Gjakovë, për pajisjen me certifikatën për shërbimin me pije alkoolike, nga i dëmtuari ka marrë shumën e parave prej 500,00 €, për ta pajisur me këtë certifikatë por i akuzuari nuk e ka pajisur. Në fjalën e tij përfundimtare të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 30.06.2015, ka deklaruar se me provat e administruara u vërtetua se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe kjo u vërtetua nga mbrojtja e të akuzuarit A. L., deklarata e të dëmtuarit M. N., nga dëshmia e dëshmitarëve si dhe nga provat materiale. Ka shtuar se është vërtetuar se i akuzuari A. L. në cilësinë e inspektorit të bujqësisë pranë Kuvendit Komunal në Gjakovë nga viti 2010 e deri në vitin 2014, ka keqpërdor pozitën e tij zyrtare me qëllim që vetës ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm ashtu që nga i dëmtuari M. N., pronar i hotelit "E." në Gjakovë, lidhur me pajisjen e certifikatës për pije alkoolike i akuzuari i ka marrë të hollat nga këtu i dëmtuari dhe atë shumat prej 500,00 €, ndërsa ka paguar në bankë shumat për vitin 2010, shumën prej 200,00 €, për vitin 2011 shumën prej 200,00 €, ndërsa për vitin 2012 shumën prej 300,00 € dhe fare nuk e ka pajisur me këto certifikata ashtu që në mënyrë të kundërligjshme i ka marrë këto shuma të parave. Ka shtuar se nga deklarata e dëshmitarëve Sh. N., A. D., G. R. dhe dëshmitarët tjerë është vërtetuar fakti se hotel "E." sipas rregullores së Kuvendit Komunal në Gjakovë është dashur të paguaj çdo vitë taksë në shumën 500,00 €, për tu pajisur me certifikatë për pije alkoolike dhe i akuzuari nuk ka vepruar sipas kësaj rregulloreje edhe pse obligim për ta paguar taksën ka pasur i dëmtuari M. N. por i akuzuari i ka marrë paratë në dorë nga pala e dëmtuar duke bërë pagesën pjesërisht, ndërsa shumat tjera të parave i ka përvetësuar dhe nuk e ka pajisur të dëmtuarin M. N. me këtë certifikatë. Ka theksuar se i propozon trupit gjykues që të akuzuarin ta shpallë fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ti shqiptoi një dënim sipas ligjit dhe ta obligoi në shpenzimet e procedurës penale si dhe nga i akuzuari të konfiskoi shumën e parave prej 1300,00 €, të cilat i akuzuari i ka përfituar në mënyrë të kundërligjshme. Ka shtuar se gjatë caktimi të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata ti merre parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat qëndrojnë në anën e të akuzuarit, e sidomos faktin se i akuzuari ka vepruar në vazhdimësi në kryerjen e veprës penale.

I akuzuari **A. L.** që në fillim të shqyrtimit gjyqësor duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se nuk e pranon fajësinë për këtë veprë penale. Gjatë mbrojtjes së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 19.06.2015, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e mbrojtësi të tij ka deklaruar se si inspektor ka punuar fillimisht nga viti 1991-1992, kur është larguar nga puna e pastaj ka filluar sërish nga viti 1999 e deri ditën e suspendimit. Ka shtuar

se si inspektor i bujqësisë është i autorizuar gjegjësisht e ka në përshkrim të detyrave të punës ta bëjë inspektimin e produkteve bujqësore, plehrave kimike, farave, pesticideve, tokat bujqësore, mbledhjen e tokave dhe korrje shirjet edhe një ndër detyrat e punës është edhe lëshimi i urdhëresave gjegjësisht inspektimit për tu pajisur me certifikata për shërbime me pije alkoolike. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera të mbrojtësit ka deklaruar se obligim i tyre është që të shkojnë në subjektet afariste kur tregtojnë me pije alkoolike dhe të japin urdhëresën që ta bëjnë pagesën dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim në zyrën e pranimit të kërkesave në kuadër të Kuvendit Komunal në Gjakovë. Ka shtuar se dokumentacioni i nevojshëm për të pajisur me certifikatë për shërbime me pije alkoolike janë fletë-pagesa, aktvendimi për plotësimin e kushteve higjieniko-tekniko- sanitare, letër njoftimet e stafit-kamerierëve dhe certifikata e biznesit dhe i gjithë dokumentacioni duhet të jetë në fotokopje, e vetëm dëshmia e pagesës në bankë duhet të jetë në original dhe këtë dokumentacion duhet ta përgatit vet pala dhe personalisht duhet ta bëjë dorëzimin e atij dokumentacioni në Kuvendin Komunal. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera të mbrojtësit ka theksuar se ka qenë gjatë vitit 2010 në N.H.SH "E." në restorantin i cili është i ndarë nga pjesa e hotelit dhe i ka dhënë urdhëresë që të bëhet pagesa prej 200,00 € dhe 1 €, janë shërbime të bankës e njëjta procedurë ka ndodhur edhe në vitin 2011 ndërsa në vitin 2012 restoranti ku është bërë pagesa prej 200,00 € është mbyllur dhe është hapur një sallë e re restorant me madhësi më të madhe se 100 metra, me ç' rast është japur urdhëresa që të bëhet pagesa prej 300,00 € plus shërbimet e bankës. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësi se a është pajisur pronari me certifikatë të pijeve alkoolike, ka theksuar pasi lënda me kërkesë nuk i drejtohet atij, por drejtorit të drejtorisë për inspeksion, i cili është përgjegjës për marrjen e lëndës, shikimin, përpilimin e certifikatës dhe dorëzimin e lëndës palës dhe arkivimin e saj në bazë të kërkesës që ka bërë pala dhe nuk është në dijeni a është pajisur M. N. me certifikatë, pasi për atë ka kompetencë drejtori. Ka shtuar se në vitin 2013 e ka vizituar-inspektuar N.H.SH "E." së bashku me dy koleget, inspektore të tregut dhe kanë bërë urdhëresën për tu pajisur me certifikatë për vitin 2013, ndërsa për vitin 2014 nuk ka qenë në inspektim. Ka shtuar se ka pasur raste kur kanë bërë vet inspektorët pagesa, në emër të subjekteve afariste, për këto shërbime me të vetmin qëllim që të realizohet norma e të hyrave në buxhetin komunal dhe duke llogaritur se ka punuar i vetëm edhe pse me rregullore është dashur të angazhohet gjithsejtë 6 inspektor dhe atë 4 të tregut dhe 2 të bujqësisë dhe askush nga eprorët asnjë herë nuk ua kanë tërhequr vërejtjen për këtë mënyrë të pagesës. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera të mbrojtësit i cili ja prezanton pagesat në emër të N.H.SH "E." dhe pyet se a keni bërë ju ndonjëherë nga këto pagesa, është përgjigjur ekziston mundësia nuk është i sigurtë për cilin vit, për shkak të azhuritit dhe realizimit e normës, ka mundur që të bëjë pagesën, por pagesat siç shihet edhe nga tabela e pagesave janë derdhur në xhirollogari të komunës dhe atë me datë 14.04.2010 janë paguar 200,00 €, me datë 29.04.2011 janë paguar 200,00 € dhe me datë 18.06.2012 janë paguar 300,00 € ndërsa për vitin 2013 nuk ka bërë pagesë. Ka shtuar se bazuar në rregullore pasi të kompletohet dokumentacioni duhet të pritët 7 ditë për tu pajisur me certifikatë po qe se nuk ka mangësi në dokumentacioni. Ka theksuar se gjatë inspektimeve në N.H.SH "E." ka qenë i shoqëruar nga koleget dhe në pyetjen se për cilën veprimtari është bërë pagesa për certifikatë për shërbime me pije alkoolike për N.H.SH" E." është përgjigjur pagesa është bërë për veprimtari sekondare me kod 4711, ku parashihet tregtia me pakicë në dyqanet jo të specializuara, ku mbizotëron tregtia me pakicë me ushqim, pije dhe duhan. Ka shtuar se sa i përket certifikatës së lëshuar

për vitin 2010, e cila nuk ka nënshkrim e as vulë origjinali i dërgohet palës, ndërsa personalisht nuk e dinë pse drejtori nuk i ka nënshkruar dhe vulosur dhe beson se nuk është vetëm kjo certifikatë, por të gjitha dhe drejtor ka qenë A. K.. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera të mbrojtësit se N.H.SH "E." për vitin 2010, ka një certifikatë ndërsa për vitet 2011-2012, ka dëshmi pagese por nuk ka certifikatë, është përgjigjur se beson se këtë pronari e ka bërë nga mos dija edhe pse në procesverbal është urdhëruar që të pajiset me certifikatë, kjo dukuri i ka përcjellë shumë afarist për shkak të një burokracie, gjegjësisht numrit të madhe të dokumentacionit që kërkohet për tu pajisur me këtë certifikatë. Ka theksuar se asnjë herë nuk ka qenë në gjykatë, për ndonjë shkelje si dhe asnjëherë nuk i është shqiptuar vërejtje nga ana e punëdhënësit, por ka marrë mirënjohje. Duke u përgjigjur në pyetjet e prokurorit ka shtuar se gjatë vitit 2010 kur ka qenë në inspektim në N.H.SH" E." nuk i kujtohet a e ka takuar M. N. por mund të jenë dy mundësi ta ketë takuar M. apo vëllain e tij L. dhe nuk i kujtohet se gjatë vitit 2010 a ja ka dhënë paratë për ta kryer pagesën por ka theksuar se ekziston mundësia që të ja ketë dhënë por për vitin 2010 ka paguar 200,00 € dhe një euro për shërbimet e bankës dhe nuk është e vërtetë që i dëmtuari i ka paguar 500,00 € për vitin 2010 por i njëjti ka paguar 200,00 € dhe për këtë ekziston dëshmia që ai i ka paguar 200,00 €. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera të prokurorit ka theksuar se nuk e dinë se kopja e certifikatës në lëndë është pa vulë dhe nënshkrim pasi këtë e bënë drejtori, pra pranin dorëzimin e lëndës dhe arkivimin e saj e bënë drejtori. Ka shtuar se normalisht kur përpilon procesverbalin e inspektimit e merre certifikatën e biznesit dhe e ka vërejtur se veprimtari primare e këtij subjekti afarist është hotel dhe akomodim i ngjashëm, por arsyeja pse nuk është bërë pagesa për hotel si veprimtari primare, por pagesa është bërë për veprimtari sekondare, është se vendin ku e ka trajtuar alkoolin ka qenë 40 m2 dhe nuk ka pasur 4-5 tavolina, pra nuk ka pasur metra katrorë më shumë që të taksohet në vlerën mbi 200,00 €. Ka theksuar se gjatë vitit 2012 M. N. ka hapur restorantin e ri dhe nuk e ka pasur pëlqimin se a i plotëson kushtet për pjesën e re dhe nuk i ka thënë M. N. se do ti ndihmoi, por i njëjti ka deklaruar se ai i mbanë dy futbollist të KF "Vëllazërimi" si kontribut për Komunën e Gjakovës. Ka shtuar se asnjë herë nuk ka pasur kërcënime apo kanosje nga i dëmtuari M. N. dhe për deklaratën e tij të dhënë në prokurori me datë 15.12.2014, ku ka theksuar se M. N. i ka dërguar dy mesazhe nga telefoni dhe të njëjtat i ka konsideruar si shantazhe ka theksuar se i kërkon falje M. N. për ofendimet që ia ka bërë ndërsa pagesat është reale që i ka bërë. Duke u përgjigjur në pyetjet e gjykatës ka deklaruar se urdhëresën që ta bëjë pagesën e bëjnë në fletë pagesë, që janë speciale për tu konstatuar se pagesat janë kryer. Duke u përgjigjur në pyetjen tjetër se gjatë inspektimit të vitin 2012-2013 keni konstatuar se subjekti afarist e ka të regjistruar veprimtarin hoteliere, por certifikatën për pije alkoolike e ka të skaduar dhe ja keni dhënë vërejtjen në procesverbal për të aplikuar menjëherë gjatë vitin 2012 kur keni qenë në inspektim ku e keni parë certifikatën për vitin 2011 si dhe gjatë inspektimit të bërë gjatë vitin 2013, ku e keni parë certifikatën për vitin 2012, ku i dëmtuari nuk ka pasur fare certifikatë, është përgjigjur se ata udhëhiqen nga kartela financiare, ku shihet se secili subjekt e ka bërë pagesën e atëherë konsiderohet se certifikata është e skaduar dhe gjatë inspektimit nuk e ka kërkuar certifikatën. Duke u përgjigjur në pyetjen tjetër se në pyetjet e mbrojtësit theksuat se për vitin 2010, e keni detyruar që të paguaj 200,00 € pasi lokalit ka pasur më pak se 100 m2, ndërsa për vitin 2012, e keni detyruar që të paguaj 300,00 €, me arsyetimin se ka krijuar sallë të re me hapësirë më të madhe ku e kanë caktuar këtë fakt është përgjigjur nuk e kanë bërë matjen, por pagesa është caktuar në bazë të shikimit me sy. Ka shtuar se nuk është

e vërtetë që nga i dëmtuari M. N. për vitin 2010 ka marrë 500,00 €, ndërsa ka paguar 200,00 €, po ashtu nuk është e vërtetë për vitin 2011 ka marrë 500,00 € dhe ka paguar vetëm 200,00 €, si dhe nuk është e vërtetë se për vitin 2012 i ka thënë të dëmtuarit se do ti ndihmoi dhe do të ja bëjë pagesën 300,00 €, por ka theksuar se ka mund të ndodhë që ta bëjë pagesën në emër të M. N..

Me provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor publik dhe pas vlerësimit dhe analizimit të tyre veç e veç dhe të ndërlidhura me njëra tjetrën, Gjykata ka konstatuar se me asnjërin nga provat e administruara nuk është vërtetuar se i akuzuari A. L. e ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së, të përshkruar në pjesën lirues të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike Gjykata e ka vërtetuar nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor si dëshmia e të dëmtuarit M. N. e dhënë në cilësinë e dëshmitarit gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.04.2015 dhe në prokurori me datë 29.12.2014, dëshmia e dëshmitares I. M. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.04.2015 dhe në prokurori me datë 12.12.2014, dëshmia e dëshmitares H. Ll. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.04.2015, dëshmia e dëshmitarit Sh. N. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 08.05.2015 dhe në prokurori me datës 12.12.2014, dëshmia e dëshmitarit A. D. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 08.05.2015, dëshmia e dëshmitarit G. R. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 10.06.2015, raporti i përgjithshme i Drejtorisë për Agrokulturë dhe Inspeksion për vitet 2014, 2013, 2012, 2011 dhe 2010, certifikata e Drejtorisë për Punë Inspektuese për N.H.T.”E.” e datës 05.08.2014 për shërbime me pija alkoolike, certifikata e Drejtorisë për Punë Inspektuese e N.H.T.”E.” e datës 13.04.2010 për shërbime me pija alkoolike, certifikata e regjistrimit të biznesit për N.H.SH. “E.”, fatura me numër 00097 e datës 13.04.2010 e Drejtorisë së Inspeksionit, leja e punës për N.H.SH.”E.” e lëshuar nga Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim e datës 05.05.2008, procesverbali i inspektoriatit të bujqësisë me numër 51-2014 të datës 14.08.2014, lidhur me inspektimin me subjektin afarist “E.”, procesverbali i Drejtorisë së Inspeksionit i datës 25.06.2013 lidhur me kontrollin, inspektimin në subjektin afarist “E.” procesverbali i Drejtorisë së Inspeksionit i datës 02.05.2012, lidhur me kontrollin dhe inspektimin në subjektin afarist “E.”, procesverbali i Drejtorisë së Inspeksionit i datës 13.04.2011, lidhur me kontrollin dhe inspektimin në subjektin afarist “E.”, procesverbali i Drejtorisë së Inspeksionit i datës 31.03.2010 lidhur me kontrollin dhe inspektimin në subjektin afarist “E.”, pagesa e kryer në Bankën Ekonomike në emër të N.H.SH. ”E.” me datë 28.04.2011, pagesa në Bankën Ekonomike në emër të N.H.SH. ”E.” e datës 08.06.2011, të dhënat për qarkullimin financiar në llogarinë bankare për të akuzuarin A. L., nga kartat financiare të Drejtorisë së Inspeksionit për vitet 2014, 2013, 2012, 2011 dhe 2010, si dhe nga vet deklarata e të akuzuarit e dhënë gjatë mbrojtjes së tij.

I dëmtuari M. N. gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.04.2015, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka deklaruar se i akuzuari A. L. ka ardhur në inspektim në lokalit e tij hotel “E.” dhe ka kërkuar që të pajiset me certifikatën për shërbime me pije alkoolike një vjeçare, ka bërë pagesën në vlerë 500,00 €, të cilat ia ka japur të akuzuarit A. L. fillimisht për vitin e parë 2009-2010 dhe ditën e nesërme e ka pajisur me këtë certifikatë, pra ja ka sjellë certifikatën një vjeçare dhe nuk ja ka kërkuar dëshminë e pagesës. Ka shtuar se nga viti 2010 deri në vitin 2014 ka paguar nga 500,00 €, me

përrjashtim të një viti sa i kujtohet viti 2012 ka paguar vetëm 300,00 €, pasi që i ka thënë se do të i ndihmoi dhe nuk do ta bëjë në cilësinë e hotelit por të restorantit, e për këto vite nuk e ka pajisur me certifikatë, e as me dëshmi të pagesës dhe kur e ka bërë pagesën e ka kryer për një vit dhe nuk është ardhur për një vit në inspektim e vet e ka mbajtur certifikatën e vitit 2010. Ka theksuar se në vitin 2014 sa i kujtohet nuk ka qenë A. L. në inspektim por ka qenë A. D. dhe A. D. i ka thënë se zakonisht nuk i lejohet që ti marrin paratë në dorë, por pasi ky ka pasur dy dasma dhe në atë moment nuk ka pasur rrymë i ka thënë nuk po të obligoi që të dalësh nga objekti dhe ja ka marrur pagesën në shumën prej 502,00 € dhe afërsisht brenda 40 minutave e ka sjellur certifikatën për pije alkoolike dhe pagesën nga Banka Ekonomike. Ka shtuar se me të akuzuarin ka komunikuar përmes telefonit, fillimisht e ka thirrur në telefon ka qenë në Shqipëri e pastaj i ka shkruar mesazhe e ka përshëndetur dhe i ka kërkuar që të vije dhe të konsultohen për mbetjet e pa paguara, pasi ai ka pasur për qëllim që i akuzuari ti paguaj mbetjet dhe të mos ndiqet penalisht sepse për këtë borxh ndaj Kuvendit Komunal është njoftuar nga Policia e Krimeve Ekonomike në Pejë edhe pse vet nuk ka paraqitur asnjë rast, as në polici e as në Kuvendin e Komunës. Duke u përgjigjur në pyetje tjera të prokurorit se ju po thuani se keni paguar shumën prej 500,00 €, e i akuzuari nuk e ka sjellë certifikatën kur jeni takuar me të akuzuarin a e keni pyetur për certifikatën dhe pagesën është përgjigjur jo, nuk e ka pyetur pasi ka menduar se një herë e bënë pagesën e vlen certifikata e vitit 2009-2010. Ka theksuar se këtë afarizëm e ushtron nga viti 2004, ndërsa pagesa për shërbime me pije alkoolike ka filluar nga viti 2009-2010 dhe atë vetëm e kanë njoftuar inspektorët e kanë kryer pagesën, por nuk ka shkruar personalisht në Kuvendin Komunal dhe nuk i kujtohet se a ka bërë një kërkesë të tillë në Kuvendin Komunal, por ka mund të jetë që vëllai i tij L. i cili e ka zëvendësuar kohë pas kohe, ka bërë një kërkesë të tillë. Ka shtuar se në momentin kur ka bërë pagesat brenda në lokal ka qenë vetëm inspektori A., e jashtë objektit kanë qenë edhe inspektorët tjerë, e vetëm mban mend inspektoren H., ndërsa gjatë vitit 2014 në inspektim ka qenë A. D. së bashku me Sh. N.. Duke u përgjigjur në pyetjet e gjykatës se gjatë inspektimit inspektorët a kanë përpiluar procesverbal dhe është përgjigjur herën e parë gjatë 2009-2010 kanë përpiluar procesverbal, ndërsa vitet tjera nuk ka pasur kurrfarë procesverbali dhe në lokalin e tij nuk kanë përpiluar asnjë procesverbal. Në pyetjen tjetër se ku e dinit ju se duhet mi paguar 500,00 €, ka theksuar ka qenë i njoftuar me vendimin e Kuvendit Komunal se për hotele pagesa është 500,00 € dhe për tu pajisur me këtë certifikatë zakonisht duhet të shkohet në Kuvendin Komunal, por në këtë rast i akuzuari A. L. vazhdimisht ka shkruar në lokalin e tij. Ka shtuar se për certifikatën e parë për vitin 2009-2010 e ka parë fletë pagesën ka qenë 500,00 €, ndërsa për vitin 2011 dhe 2012 nuk e ka parë fletë pagesën kurse sa i përket vitin 2013 mendon se e ka paguar vëllai i tij L. dhe se zakonisht si pronar pagesat i bënë vet por në vitin 2009 ka qenë i pranishëm edhe vëllai i tij L.. Duke u përgjigjur në pyetjet e gjykatës se në shkresat e lëndës ekzistojnë procesverbalet e inspektimit të datës 13.04.2011, 02.05.2012, 25.06.2013, 14.08.2014, ku është e konstatuar se inspektorët kanë qenë në inspektim në hotelin “E.” dhe i është përpiluar procesverbal pas shikimit të këtyre procesverbaleve ka deklaruar se procesverbali i viteve 2011, 2012 dhe 2013, është nënshkruar nga vëllai i tij L. N. pasi e njuh nënshkrimin e tij kurse procesverbali i vitit 2014 është nënshkruar personalisht nga vet ai. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera ka deklaruar se personalisht i ka kryer vet pagesat por ka qenë edhe vëllai i tij L. i cili është marrë me këto çështje, ndërsa sa i përket deklaramit se për vitin 2009-2010 ka paguar 500,00 € dhe pasi nga ana e Gjykatës është ofruar dëshmia nga Banka Ekonomike e datës 13.04.2010 dhe 28.04.2011 ku është e

konstatuar se pagesa është në shumën prej 201,00 € ka theksuar se vet nuk ka paguar në bankë të gjitha pagesat i ka bërë A. L. dhe vetëm një herë ja ka mundësuar 300,00 €, ndërsa herëve tjera ka paguar 500,00 €. Ka shtuar se nuk mban shënime për shpenzime për shpenzime por zakonisht merret kontabilisti N. J..

Dëshmitarja **H. LI.** gjatë dëshmisë së saj të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.04.2015, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet prokurorit ka theksuar se ka qenë në inspektim në lokalit "E." me pronar M. N. dhe si inspektore e treguat e ka njoftuar se duhet parashtruar kërkesë që fillimisht të pajiset me vendim për ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe pasi ka parashtruar kërkesë dhe i ka plotësuar kushtet, i njëjti është pajisur me aktvendim, me të cilën i është lejuar ushtrimi i kësaj veprimtarie. Ka shtuar se certifikatën për shërbimin me pije alkoolike e lëshon Drejtori i Drejtorisë për Inspeksion dhe sa i përket rastit të akuzuarit A. L. së bashku me I. M. dhe A. L. për shkak të shfrytëzimit të automjetit kanë shkuar së bashku në hotel "E." në vitin 2013 për të pajisur me certifikatën, për shërbime me pije alkoolike por M. N. nuk ka qenë i pranishëm. Ka theksuar se qëllim i vizitës në lokalit "E." ka qenë pajisja me këtë certifikatë dhe kompetent ka qenë A. L., ndërsa ajo dhe I. vetëm kanë asistuar, e kanë nënshkruar procesverbalin ashtu siç edhe A. L. ka asistuar në punën e tyre inspektuese, nuk e ka lexuar përmbajtjen e procesverbalit, por qëllimi i inspektimit ka qenë që ta kryen pagesën për shërbimin me pije alkoolike. Ka theksuar se nuk ka shkuar që ta verifikoi se a e ka kryer këtë pagesë pasi nuk është në kompetencë të saj. Duke u përgjigjur në pyetjet e të dëmtuarit se si është munduar që një person zyrtar të nënshkruaj e të mos dije se çfarë po nënshkruaj, është përgjigjur jo, ajo ka ditur cili është qëllimi i inspektimit, por procesverbalin nuk e ka shkruar vet, por vetëm e ka nënshkruar. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit ka deklaruar se gjatë inspektimit së bashku me kolegët, gjatë përpilimit të procesverbalit kanë qenë brenda në objekt dhe i pranishëm ka qenë vëllai i të dëmtuarit M. N. dhe gjatë kohës së inspektimit i akuzuarit A. L., nuk ka lëvizur asnjëherë dhe nuk ka shkuar me vëllain e M. apo me ndokënd tjetër në ndonjë dhomë. Ka theksuar se për tu pajisur me certifikatën duhet të plotësohen pesë kushte paraprake siç janë kërkesa, aktvendimi për plotësimin e kushteve, certifikata e biznesit, letër njoftimet në kopje, fletë pagesa e pastaj kur të plotësohen këto lënda dorëzohet në shkrimore e pastaj drejtori e lëshon certifikatën e zakonisht nga koha e parashtrimit të kërkesës e deri te lëshimi i certifikatën kalojnë 10 ditë. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera ka theksuar se inspektorët nuk kanë të drejtë që ti marrin të hollat në objekt gjatë inspektimit, por në shenjë respekti dhe ndihmës mund të që t'ia kryer inspektori, me kushte që të ia dorëzoi fletëpagesën por kjo nuk ndodhë shpesh. Ka shtuar se kjo certifikatë duhet të lëshohet çdo vit pasi të plotësohem komulativisht ato pesë kushte dhe shuma e pagesës është e caktuar me rregullore komunale dhe si inspektor i tregut duhet ta kërkojnë atë certifikatë gjatë inspektimit dhe e njëjta duhet të jetë e ekspozuar në lokal. Ka shtuar se ka mund të bëhet ndonjë pagesë nga ana e të dëmtuar por meqenëse pagesa nuk është bërë në tërësi nuk është lëshuar certifikatë për ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe në mungesë të dokumenteve nuk kanë vepruar por zakonisht kur nuk e përmbush detyrimin brenda afati që i lihet në procesverbal lëndën e dërgojnë në gjykatë.

Dëshmitarja I. M. gjatë dëshmisë së saj të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 22.04.2015, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet prokurorit ka theksuar se si inspektore e tregut ka punuar në Kuvendin Komunal në Gjakovë nga viti 2010 deri në vitin 2014 dhe gjatë

inspektimit në hotel “E.” e kanë asistuar inspektorin A. L. Ka shtuar se A. L. ka kërkuar që M. N. të pajiset me certifikatë për shërbime me pije alkoolike, por gjatë inspektimit nuk ka qenë i pranishëm M. N. por vëllai i tij. Ka shtuar se gjatë inspektimit është përpiluar procesverbal me të cilin është japur urdhëresa për tu pajisur me atë certifikatë, por nuk ka dijeni se a është pajisur M. N. me atë certifikatë, pasi procedurën e ka vazhduar A. L., ndërsa së bashku me H. L. vetëm kanë asistuar si dhe pas këtij rasti nuk ka qenë ndonjë herë me A. L. në inspektim në lokalin “E.”. Duke u përgjigjur në pyetjet e gjykatës ka theksuar se sa i kujtohet gjatë inspektimit kanë hyrë brenda në lokal, janë ulur së bashku që të tre dhe vëllai i M. N., procesverbalin e ka përpiluar A. L. në prezencën e tyre dhe vëllai i M. N. nuk ka paguar para kesh, për tu pajisur me këtë certifikatë.

Dëshmitari **Sh. N.** gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 08.05.2015, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka theksuar se me datën 03.07.2014, si task-forcë në kuadër të Kryetares së Komunës ka themeluar marrëdhënien e punës për asistim inspektoriati për kryerjen e punëve. Ka shtuar se me datë 23.07.2014 ka shkuar në inspektim në hotel “E.” së bashku me A. D. i cili po ashtu ka qenë i punësuar në task-forcë dhe sa i kujtohet e kanë takuar edhe M. N. Ka shtuar se ata kanë shkuar për inspektim në bazë të pagesave që nuk janë bërë, sepse ai nuk e ka pasur pagesën për periudhën korrik 2013, korrik 2014, pra këto certifikata janë një vjeçare dhe duhet çdo vit të pajisen me certifikatë të re dhe M. N. nuk ka pasur certifikatë. Ka shtuar se e kanë obliguar që ta paguaj taksën në afat prej 7 ditëve dhe nuk e ka paguar taksën brenda këtij afati, kanë shkuar sërish edhe dy apo tri herë tjera gjatë fillimit të muajit gushtë, së bashku me kolegun A. D., pasi A. L. ka qenë në pushim vjetor dhe kur e kanë pyetur M. N. se a e ka bërë pagesën, ai është përgjigjur se është shumë i zanën me organizimin e dasmave dhe deri me datë 06.08.2014 nuk e ka bërë pagesën. Ka shtuar se edhe dy apo tri herë më përpara kur kanë qenë në inspektim M. N. ka dashur që tua jap paratë që ata ta bëjnë pagesën, nuk i kanë pranuar dhe atë ditë ua ka dhënë paratë në shumën prej 501,50 cent dhe të njëjtën ditë e kanë bërë pagesën dhe ja kanë kthyer një kopje të pagesës, si dhe ja kanë marrë dokumentet e nevojshme që nevojiten për tu pajisur me certifikatë. Ka shtuar se nuk e dinë se a është e paraparë me ligj, se nëse nuk bëhet pagesa të mbyllet lokali, por e dinë se në rast që nuk kryhet pagesa lënda duhet të dërgohet në gjykatë, por pasi nuk ishte i pranishëm A. L. nuk ka mund ta kryejnë këtë veprim si dhe ka qenë vullneti i M. N. që ta paguaj detyrimin e tij, e ata ja kanë marrur paratë e kur e kanë njoftuar drejtorin ua ka tërhequr vërejtur dhe ma nuk kanë vepruar në këtë mënyrë. Ka theksuar se gjatë inspektimit kanë shikuar se a kanë qenë i pajisur M. N. me certifikatën për pije alkoolike për vitet paraprake por pasi nuk ua ka prezantuar certifikatat kur ata për vitin 2014 e kanë pajisur me certifikatë, M. N. ju ka thënë se çdo vit ka bërë pagesën por pse nuk është pajisur me certifikatë nuk e dinë dhe në bazë të tabelës financiare që posedon Komuna, ai ka pasur dy pagesa e atë një herë 200,00 € dhe një herë 300,00 € por vitet nuk i dinë. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit ka deklaruar se të njëjtën ditë ja ka marrë pagesën dhe dokumentacionin M. N., tërë dokumentacionin e kanë dorëzuar në arhivën e Komunës dhe certifikata është lëshuar për dy ditë por që certifikata lëshohet me datën kur është bërë pagesa, pra nuk është pajisur me certifikatë ditën kur është bërë pagesa. Ka shtuar se kur shkojnë në inspektim dhe i detyrojnë që të kryejnë pagesën firma duhet ta kryej pagesën, e pagesës ja bashkëngjite kërkesën dhe dokumentet që kërkohen për tu pajisur me këtë certifikatë. Duke u përgjigjur në pyetjet e

gjykatës ka theksuar se kur i kanë marrë të hollat nga M. N. nuk i kanë lëshuar kurrfarë dëshmie dhe se është normale se nëse nuk e ka paguar pagesën për vitet paraprake duhet që lëndën ta dërgojnë në gjykatë por në këtë rast nuk kanë vepruar në këtë formë dhe kanë konstatuar se M. N. ka pasur vetëm dy pagesa dhe nuk kanë iniciuar procedurë kundërvajtëse kundër M. N. pasi i njëjti është ankuar te Kryetarja e Komunës dhe drejtori. Ka shtuar se pasi i akuzuari A. L. është kthyer nga pushimi nuk ka biseduar lidhur me këtë çështje sepse drejtori i inspektoriatit M. S. i ka thënë se do të merret vet me këtë çështje.

Dëshmitari **A. D.** gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 08.05.2015, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka theksuar se ka qenë në kontrolle në hotel "E." datën e saktë nuk e dinë, ka qenë sezona e verës herën e parë ka qenë së bashku me A. L. ndërsa herën e dytë ka qenë me Sh. N. Ka shtuar se nuk e ka pasur të paguar pagesën për certifikatë dhe sipas procedurës ja kanë lënë një kopje të procesverbalit dhe një fletë pagesë e cila nevojitet për tu bërë pagesa në bankë, pra kopje e procesverbalit dhe fletë pagesën ja ka dhënë kur kanë qenë në inspektim me Sh. N. Ka theksuar se kur ka qenë në inspektim me A. L. pronari nuk ka qenë aty kanë biseduar me dikend nga punëtorët, pasi nuk ishte pronari aty kanë dal menjëherë. Ka theksuar se pasi ja kanë lënë procesverbalin dhe fletëpagesën kanë shkuar sërish me Sh. N. i bie hera e tretë e kanë takuar pronarin e lokalit M. N. e i njëjti ju ka thënë se nuk ka mundësi me ardh me bërë pagesën për shkak të angazhimeve të tij-dasmave por ka theksuar se është i interesuar që ta kryen pagesën dhe ua ka dhënë para kesh në shumën prej 501,50 cent, e kanë bërë pagesën në Bankën Ekonomike dhe të njëjtën ditë ja kana dorëzuar fletë pagesën dhe një kopje e kanë ndalur vet, ndërsa certifikatën nuk e kanë dorëzuar atë ditë pasi nevojitet një procedurë ku duhet të bëhet një kërkesë duhet bashkëngjitur një kërkesë së bashku me dokumente dhe fletëpagesën të dorëzohen në Komunë e pastaj lëshohet certifikata e sa i kujtohet pas 2-3 jave e ka marrë certifikatën për vitin 2014. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit ka theksuar se kur ka qenë në inspektim së bashku me A. L. nuk kanë përpiluar procesverbal. Duke u përgjigjur në pyetjet e gjykatës ka theksuar se pasi A. L. është kthyer nga pushimi ka biseduar me te e ka thirrur edhe vet drejtori sepse zyra ku gjendjen procesverbalet çelësin e ka pasur vetëm A. L. dhe personalisht e ka njoftuar A. se e kanë thirrur policia e krimeve ekonomike, e ai ka thënë se mendon se është i pastër janë procesverbalet, shënimet. Ka theksuar se M. N. nuk ua ka prezantuar certifikatë për vitin 2012, 2013 dhe nuk kanë iniciuar procedurë ndaj tij, pasi kanë qenë me kontratë mbi vepër dhe kanë pasur autorizime vetëm për vitin 2014, e jo për vitet paraprake, andaj nuk kanë pasur autorizim për të iniciuar procedurë kundërvajtëse para vitit 2014. Ka shtuar se ndodhë që edhe kur të shkojnë në inspektim nuk përpilojnë procesverbal, zakonisht kur nuk e takojnë pronarin e lokalit pasi punëtorët hezitojnë ta nënshkruajnë procesverbalin dhe ka theksuar se është rreptësishtë e ndaluar që ti marrin të hollat në dorë edhe pse i kanë marrë te ky rast te hotel "E.", ka pasur edhe disa raste tjera, po as që i akuzuari A. ua ka thënë të ju ndihmojmë palëve që kanë obligime të shumta si dhe ka theksuar se nuk është kompetentë për tu deklaruar se a mund të pajiset me certifikatë për vitin 2014, nëse nuk ka certifikatën për vitin 2012, 2013, por kompetent janë inspektorët e vjetër. Ka shtuar se nuk e kanë të ndaluar me kontratë mbi vepër për të iniciuar procedurë kundërvajtëse, por në bazë të Rregullores Komunale inspektorët që bëjnë pjesë në task-force nuk kanë të drejtë të iniciojnë procedurë dhe në inspektim te hotel "E." kanë qenë zyrtarisht, për inspektim i raportojnë drejtorit dhe për inspektimin që kanë qenë në hotel "E." në vitin

2014 së bashku me të akuzuarin e kanë njoftuar drejtorin vetëm zyrtarisht dhe kompetencë për të shkuar në inspektim ka pasur i akuzuari A. pasi që ka qenë më i vjetër.

Dëshmitari **G. R.** gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 10.06.2015, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka deklaruar se nga hotel "E." me pronar M. N., për vitin 2010 për certifikatën për pija alkoolike ka pranuar 200,00 €, për vitin 2011 ka paguar 200,00 €, për vitin 2012 ka paguar 300,00 €, për vitin 2013 nuk është paguar asnjë pagesë, ndërsa për vitin 2014 janë paguar 500,00 € sipas Rregullores. Ka shtuar se me Rregulloren Komunale e cila ka hyrë në fuqi nga data 28.09.2007 dhe e cila nuk është ndryshuar gjegjësisht me nenin 16 është caktuar se hotelet dhe baret e natës duhet ta bëjnë pagesën 500,00 € në vit për pije alkoolike, pra pagesa e rregulltë sipas rregullores është bërë vetëm në vitin 2014. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit se a janë pagesat e njëjta për të gjitha lokalet si hotelet, restorantet, baret është përgjigjur se në bazë të nenit 16 të Rregullores Komunale është përcaktuar se hotelet dhe baret kanë për obligim të paguajnë 500,00 € në vit, për pije alkoolike, motelet dhe restorantet mbi 100 m² duhet të paguajnë 300,00 €, ndërsa nën 100 m² duhet të paguajnë 200,00 € dhe pagesat që janë bërë nga ana e palës së dëmtuar janë bërë sipas kësaj rregullore. Ka shtuar se për të konsideruar se a është pagesa e plotë në formularin gjegjësisht procesverbalin që ka hartuar inspektori është konstatuar se për lokal duhet të paguhet shuma 500,00 € pagesa është e pjesshme po qe se në procesverbal është e konstatuar se ka të bëjë me motele atëherë pagesat janë të rregullta. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera se a mos i dëmtuari ka paguar borxhin paraprak ka theksuar se kjo konstatohet nga pagesa nëse shkruan pagesë e pjesshme, atëherë nënkupton borxhin nëse shkruan pagesë e tërësishme, nuk nënkupton borxhin por pagesë definitive, si dhe pasi janë ofruar në shikim dy fatura dhe atë pagesa për vitin 2011 dhe 2012 dhe është pyetur se këto pagesa a janë të pjesshme apo tërësishme është përgjigjur se janë pagesa të tërësishme- përfundimtare për certifikatë edhe për vitin 2012 pasi shikon faturën thekson se është pagesë e tërësishme. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera se a ka pasur obligim të pa paguar nga N.SH."E." ka theksuar se sipas dokumentacionit duhet të paguhet si hotel dhe duhet të jetë 500,00 €, pagesat bëhen në bankë shënohet vetëm emri i lokalit afarist në emër të cilit është bërë pagesa, ndërsa nuk shënohet personi që ka bërë pagesën por për tu pajisur me certifikatën pagesa duhet të jetë e plotë me përjashtim vetëm nëse ka marrëveshje të shkruara. Ka shtuar se certifikata për pije alkoolike për vitin 2010 lëshohet pasi të bëhet pagesa e tërësishme por mund të lëshohet certifikata vetëm nëse ekziston një marrëveshje e shkruar në mes Kuvendit të Komunës dhe subjektit afarist për pagesë me këste por që në rastin konkret kur lejohet pagesa me këste për marrëveshjen duhet të ketë dijeni edhe zyra e financave e në këtë rast nuk ka informacion se ka pasur marrëveshje. Ka shtuar se para se të bëhet pagesa nga drejtoria e inspeksionit gjegjësisht inspektori i çështjes i jepet fatura që të bëhet pagesa dhe atë pagesë duhet ta dërgoi në drejtorin e inspeksionit e pastaj të gjitha drejtorit kanë për obligim që të bëjnë barazimin financiar e të hyrave për çdo muaj, por barazimi vjetor është obligativ. Duke u përgjigjur në pyetjet se ju po thuani se në mes të drejtorive detyrimisht duhet të bëhet barazimi vjetor financiar subjekti afarist "E.", a ka mbetur borxh në Kuvendin e Komunës ka theksuar se në çdo fund viti Komuna bënë raportin e obligimeve si për të hyrat ashtu edhe për borxhet, e ku çdo drejtori duhet ti sjell të gjitha të hyrat dhe borxhet e në rastin konkret zyrtarisht si zyrtar financiar nga ana e drejtorit së inspeksionit nuk janë njoftuar se N.H.SH. "E." për shërbimin me pije alkoolike është borxhli për vitet 2010, 2011,2012 pra në zyrën e

financave nuk është sjellë ndonjë dokumentacion dhe nuk figuron ndonjë borxh dhe kur është ftuar si dëshmitarë nuk ka ditur kush është pala e dëmtuar.

Nga raportet e përgjithshme të Drejtorisë për Agrokulturë dhe Drejtorisë për Punë Inspektuese për vitet 2014, 2013, 2012, 2011 dhe 2010, përpos për vitin 2014, është e konstatuar se M. N. ka parashtruar kërkesë dhe i është miratuar, ndërsa për asnjërin nga vitet tjera nuk është e evidentuar që M. N. ka parashtruar kërkesë.

Nga certifikata për shërbimin me pije alkoolike e datës 05.08.2014, e lëshuar nga Drejtoria për Punë Inspektuese, është e konstatuar se subjektit afarist N.T.H "E.", i është lejuar ushtrimi i veprimtarisë ekonomike-shërbimi me pije alkoolike, me konstatim se certifikata ka karakter një vjeçar.

Nga certifikata për shërbimin me pije alkoolike e datës 13.04.2010 e lëshuar nga Drejtoria për Punë Inspektuese, është e konstatuar se subjekti afarist N.H.SH. "E.", i është lejuar ushtrimin e veprimtarisë ekonomike-shërbime me pije alkoolike, me konstatimin se certifikata ka karakter një vjeçar.

Nga certifikata e regjistrimit të biznesit për N.H.SH. "E." e datës 13.04.2004, është e konstatuar se ky subjekt afarist është i regjistruar me pronar M. N. dhe si veprimtari primare ka hotelet dhe akomodim i ngjashëm, ndërsa veprimtari sekondare e ka tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani.

Nga fatura me numër 00097, e datës 13.04.2010 e lëshuar nga Drejtoria e Inspeksionit është e konstatuar se nga N.H.SH. "E."-M. N. është kryer pagesa për certifikatë të alkoolit në shumën prej 200,00 €.

Nga leja e punës e datës 05.05.2008, e lëshuar nga Drejtoria për Financa dhe Zhvillim është e konstatuar se subjektit afarist N.H.SH."E.", i është lëshuar leja e punës.

Nga procesverbali i Drejtorisë për Inspeksion me numër 51/2014 i datës 14.08.2014, është e konstatuar se gjatë inspektimit në subjektin afarist N.H.SH."E.", në prezencën e pronarit M. N., njëjti ka deklaruar se për vitin 2013, ka paguar 300,00 €, për certifikatë para kesh inspektorëve dhe ky subjekt afarist nuk ka certifikatë për pije alkoolike për vitin 2013.

Nga procesverbali i Drejtorisë së Inspeksionit i datës 25.06.2013, ku inspektorët kanë qenë në inspektim te subjekti afarist "E." është e konstatuar se certifikatën për shërbime me pije alkoolike e ka të skaduar dhe është urdhëruar që menjëherë ta bëjë pagesën dhe të aplikoj për certifikatë.

Nga procesverbali i Drejtorisë së Inspeksionit i datës 02.05.2012, kur inspektorët kanë qenë në inspektim në subjektin afarist "E.", është konstatuar se certifikata për shërbime me pije alkoolike është e skaduar dhe i është dhënë vërejtja me shkrim që me një herë të aplikoi për certifikatë të re.

Nga procesverbali i Drejtorisë së Inspeksionit i datës 13.04.2011, kur inspektorët kanë qenë në inspektim në subjektin afarist "E.", është konstatuar se certifikatën për shërbime me pije alkoolike e posedon por duhet ta nxjerr të renë në afatin prej 7 ditëve.

Nga procesverbali i Drejtorisë së Inspeksionit i datës 31.03.2010, kur inspektorët kanë qenë në inspektim në subjektin afarist "E.", është konstatuar se certifikatën e pijeve alkoolike nuk e posedon dhe i është dhënë vërejtja që në afatin prej 7 ditëve të aplikoi për certifikatë për pije.

Nga pagesa e kryer në Bankën Ekonomike e datës 28.04.2011, në emër të N.H.SH. "E." është e konstatuar se në emër të këtij lokali afarist për certifikatë për pije alkoolike janë paguar 201,00 €.

Nga pagesa e kryer në Bankën Ekonomike e datës 08.06.2011, në emër të N.H.SH. "E."-M. N. është konstatuar se është kryer pagesa për certifikatë të alkoolit në shumën prej 300,00 €.

Nga të dhënat për qarkullim financiar nga llogaria bankare e të akuzuarit A. L. janë të konstatuar transaksionit financiare por që janë kryer nga xhirrollogaria e të akuzuarit, por që nuk është konstatuar asnjë qarkullim financiar që ndërlihet me N.H.SH. "E.".

Nga kartela financiare e lëshuar nga ana Drejtorisë së Inspeksionit për vitin 2014 është e konstatuar se për N.H.SH. "E." kredia është 500,00 €.

Nga kartela financiare të lëshuar nga ana Drejtorisë së Inspeksionit për vitin 2013 është e konstatuar se N.H.SH. "E." nuk e ka bërë pagesën gjegjësisht pagesa nuk ekziston.

Nga kartela financiare të lëshuar nga ana Drejtorisë së Inspeksionit për vitin 2012 është e konstatuar se N.H.SH. "E." me datë 19.06.2012 ka paguar 300,00 €.

Nga kartela financiare të lëshuar nga ana Drejtorisë së Inspeksionit për vitin 2011 është e konstatuar se N.H.SH. "E." ka paguar 200,00 €.

Nga kartela financiare të lëshuar nga ana Drejtorisë së Inspeksionit për vitin 2010 është e konstatuar se N.H.SH. "E." ka paguar 200,00 €.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. L., avokati N. D. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I nr. 267/14 të datës 05.01.2015, i mbrojturi i tij A. L. ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPK-së, se kinse në periudhën kohore nga viti 2010 e gjerë me në vitin 2014 deri sa ishte në cilësinë të inspektorit bujqësore në Komunën e Gjakovës ka pranuar të holla në mënyrë të kundër ligjshme nga i dëmtuari M. N. dhe atë në shumë prej 500,00 €. Ka shtuar se edhe në kundërshtimet e tyre të mëhershme, kanë kërkuar që të hedhet aktakuza, në mungesa të provave rreth ekzistimit të disa fakteve kanë kundërshtuar nga se prokuroria gjatë hetimit nuk i ka eliminuar shumë dilema dhe paqartësi e të cilat u konstatuan edhe gjatë këtij shqyrtimi ashtu që aktakuzën këto paqartësi e bëjnë gatë në tërësi të parregullt e sidomos sa i përket shumës së të hollave që prokuroria pretendon se i akuzuari i ka përvetësuar gjatë ushtrimit të autorizimeve të tija ligjore si inspektor. Ka theksuar se në dispozitiv të aktakuzës thuhet se janë përvetësuar 500,00 €, në pjesën ku ka të bëjë me propozimet potencon se kemi të bëjmë me 800,00 €, si dhe lëshime të tjera që ndoshta nuk ia vlen që të diskutohen. Ka shtuar se gjendja e fakteve të pakundërshtueshme kundrejt të akuzuarit A. L. lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet është kjo, i akuzuari A. L. deri në suspendimin e tij ka

qenë inspektor i bujqësisë pranë Komunës në Gjakovë, këto punë dhe detyra të punës i ushtron para luftës dhe pas lufte do të thotë ka mbi 20 vite dhe se në vitin 2010, 2011 dhe 2012, e ka inspektuar subjekti hotelier E. me pronar M. N., lidhur me detyrimin e tij për tu pajisur me certifikatë për pije alkoolike, këtu i dëmtuari ka paguar shumat e të hollave dy herë nga 200 € dhe një herë 300 €, për këtë pagesa i dëmtuari vetëm një herë është pajisur me certifikatë pasi ka bërë kërkesën për lëshimin e saj ndërsa dy herë të tjera nuk ka bërë kërkesa dhe nuk ka pasur certifikatë. Ka theksuar se gjatë çdo vizite në hotel “E.” i pandehuri ka qenë së bashku me inspektorët e tjerë këtu dëshmitarët H. L. dhe I. M., si dhe me rastin e çdo vizite-inspektimi për parregullsitë lidhur me certifikatën e kërkuar ju është lëshuar ndonjë vërejtje apo është përpiluar procesverbal, andaj edhe pas procedimit të provave kanë ngelur shumë fakte të kundërshtueshme, e sidomos ai me i rëndësishme se të hollat nga dispozitivi në shumë prej 500,00 €, a ju kanë dhënë te pandehurit ashtu siç ai pretendon apo të njëjtat ju kanë dhënë kohë pas kohe nga viti 2010 e gjerë 2013 për tu pajisur me certifikatë për pije alkoolike. Ka shtuar se i akuzuari në mbrojtjen e tij pohon faktin se nga i dëmtuari ka pranuar shumën e të hollave prej 500 euro dhe atë për vitet 2010, 2011 dhe 2012 të cilat të holla janë paguar përmes bankës e për llogari të komunës dhe i dëmtuari vetëm në vitin 2010 ka ushtruar kërkesë për marrjen e certifikatës pasi që ka bërë pagesën ndërsa për dy vitet tjera 2011 dhe 2012, nuk ka bërë kërkesë dhe ka mbetur pa u pajisur me certifikatë. Ka theksuar se i pandehuri pohon se lëshimin e certifikatës e bënë dikush tjetër dhe se nuk është ai kompetent që të e lëshon dhe se e njëjta lëshohet pasi që të bëhen pagesat dhe të bëhet kërkesa me shkrim, si dhe i pandehuri pohon faktin se shpesh të hollat për pagesa të certifikatës i ndihmohet bizneseve edhe pse kjo praktik nuk është në pajtim me ligjin por kështu është vepruar deri sa askush nga eprorët nuk na ka tërhequr vërejtjen, andaj pohimet e të pandehurit kanë mbështetje në faturat për pagesat e bërë për vitin 2010, 2011 dhe 2012 në Bankën Ekonomike Filiala në Gjakovë kanë mbështetje në pasqyrat tabelare të lëshuara nga drejtoria përkatëse e Komunës së Gjakovës ku shifet se ato mjete janë derdhur në llogari të komunës e jo në xhepat e të pandehurit siç pretendon akuza. Ka shtuar se deponimet e dëshmitarëve H. L. dhe I. M. vërtetojnë faktin se ato kanë qenë në inspektim së bashku me të pandehurin në hotel “E.” kanë hyr brenda kanë kontaktuar jo këtu me të dëmtuarin por me vëllain i tij në prezencë e të treve dhe palës nga hoteli është përpiluar procesverbal dhe nga ai procesverbal është udhëzuar se si të veprohet, dëshmitarët po ashtu vërtetojnë faktin se në kohën deri sa kanë qenë në inspektim nuk kanë vërejtur të pandehurin që është larguar nga ato dhe ka biseduar veçmas me të dëmtuarin apo personat të tjerë, e këto dëshmitare vërtetojnë pohimet e të pandehurit për procedurën dhe mënyrën se si sigurohet certifikata për pije alkoolike. Ka theksuar se të njëjtat fakte lidhur mënyrën e pagesës për certifikatë dhe procedurën e pajisjes me certifikatë të pijeve alkoolike i kanë vërtetuar edhe dy dëshmitarët e tjerë A. D. dhe Sh. N. të cilët e kanë pajisur të dëmtuarin me certifikatë për vitin 2014 e të cilët i kanë marrur të hollat nga i dëmtuari ashtu siç ka vepruar i pandehuri më herët për të bërë pagesën në bankë. Ka shtuar se dëshmitari përfaqësuesi i Drejtorisë për Financa të Komunës së Gjakovës në deponimin e tij është deklaruar rreth vërtetësisë së faturave dhe pasqyrave tabelore i cili vërteton se faturat janë fikse nuk janë të pjesshme pagesat e bëra si dhe pasqyrat tabelore vërtetojnë se mjetet e paguara përmes faturave janë derdhur në llogari të komunës, e po ashtu gjatë këtij shqyrtimi janë administruar edhe shumë prova tjera materiale të cilat vërtetojnë pohimet e të pandehurit siç janë procesverbalet e lëshuara nga inspektori këtu i pandehuri për inspektimet e bëra si tërheqja e vërejtje për

pajisje me certifikatë, pastaj është administruar si prove edhe certifikata e biznesit për subjektin N.SH. "E." ku pos veprimtarisë primare hoteliere ky subjekt ka pasur edhe veprimtarinë sekondare dhe atë të pijeve alkoolike e për të cilën veprimtari inspektorët e kanë pajisur me certifikatë kur i dëmtuari ka kryer obligimet ligjore për të u pajisur. Ka theksuar se këto janë provat që mbështesin faktin se i pandehuri nuk ka kryer vepër penale siç pandehet përvetësim të hollash por të njëjtat i ka pranuar me qëllim që N.SH. "E." të pajiset me certifikatë e cila kërkohet për pije alkoolike ku i njëjti pos pagesës që ka bërë për tri vite vetëm për vitin 2010 ka bërë kërkesë me shkrim dhe për atë vite është pajisur me certifikatë. Ka shtuar se hetimi ka filluar dhe aktakuza është ngritur vetëm mbi bazën e deponimit të dëmtuarit se ka paguar 500 euro për të pajisur me certifikatë të pijeve alkoolike, andaj edhe gjatë këtij shqyrtimi, pas deklarimit të dëmtuarit, ky fakt ka mbetur ashtu siç ka qenë, i vetmuar, i pa qartë dhe jo i besueshëm për shkak se asnjë nga provat që janë administruar nuk e mbështesin pohimin e të dëmtuarit se janë dhënë të hollat në shumën prej 500,00 €, siç ai deklaron. Ka theksuar se i pandehuri në deponimin e tij fillimisht nuk saktëson se kur i ka dhënë ato të holla, a i ka dhënë për çdo vitë apo vetme një herë, nuk sqaron se ku dhe si i ka dhënë edhe pse është pronar i N.SH. "E." nuk ka njohuri të mjaftueshme se si menaxhohet dhe se si sigurohet certifikata për pajisje për pije alkoolike, nuk i kujtohet se sa herë ka qenë në hotel kur i ka kontaktuar inspektorët, a ka qenë ai apo ka qenë vëllai i tij si dhe shumë detaje të tjera që me të vërtetë e vejnë në dyshim kredibilitetin provues të asaj dëshmie, ashtu që deponimet e të dëmtuarit bien në kundërshtim me të gjitha provat që janë administruar e sidomos me deponimet e dëshmitarëve, faturat mbi pagesën dhe pasqyrave tabelore ku vërtetojnë se shumat prej 200 € dhe 300 € janë derdhur në buxhetin e komunës. Ka shtuar se pasi nuk është bërë hetim i mirëfilltë i sidomos rreth faktit se si është thirrur në polici si është intervistuar me gjasë i dëmtuari duke e ndier veten të pasigurt se a mos është thirrur për ndonjë shmangie nga tatimi apo për ndonjë vepër tjetër lidhur me biznesin e tij ka deklaruar ashtu siç ka deklaruar sepse në deponimin e tij së në polici dhe në prokurori fare nuk është ballafaquar me shumë prova materiale të cilat janë administruar gjatë këtij shqyrtimi, prandaj pranë gjendjes së përshkruar të fakteve, pa mëdyshje rezulton se i akuzuari A. L. nuk ka kryer vepër penale siç akuzohet mbrojtjes së tij duhet falur besimi nga se ka mbështetje në të gjitha provat që janë administruar, pasi që e vetmja provë që i ka mbetur akuzës është deponimi i të dëmtuarit, ashtu siç është e pamjaftueshme, e pa besueshme, e pa qartë dhe kemi të bëjmë me të vetmen provë ku në asnjë mënyrë askush nuk e mund të shpallet fajtor. Ka theksuar se ky deponim i të dëmtuarit është i pa mjaftueshëm për ta rrëzuar prezumimin e pafajësisë së të mbrojturit të tij, pa besueshmëria dhe pamjaftueshmëria e kësaj prove, përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit A. L. për veprën që i vihet në barrë, bile përgjegjësinë e tij penale për këtë vepër e bëjnë të dyshimtë për çfarë parashtron se kur çështja faktike paraqitet e dyshimtë duhet vendosur në favor të pandehurit (neni 3 i KPP-së "in dubio pro reo"), prandaj edhe një herë e përsëritë se prokuroria nuk ka arritur që i provoj faktet apo pretendimet e ngritura nga aktakuza sa i përket të mbrojturit të tij, andaj lut trupin gjykues që më rastin e vlerësimit dhe analizimit të provave të administruara, bindjen dhe konkludimet të i bazon në provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i propozuar gjykatës që të bie vendim lirues.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e Prokurorisë të parashtruara si në aktakuzë ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor se i akuzuar A. L. ka kryer veprën penale

keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së, me arsyetimin se i akuzuari me qëllim të përfitimit pasuror të kundërligjshëm nga i dëmtuari M. N. si pronar i hotelit "E.", për ta pajisur me certifikatën për shërbime me pije alkoolike ka marrë për vitin 2010, të hollat në shumën prej 500,00 € dhe ka paguar vetëm 200,00 €, po ashtu për vitin 2011 ka paguar vetëm 200,00 €, ndërsa për vitin 2012 ka paguar 300,00 € dhe nuk e ka pajisur me certifikatë dhe gjykata ka konstatuar se pretendimi i tillë i prokurorisë është i pa bazuar për faktin se këtë pretendim prokuroria e ka mbështetur dhe bazuar vetëm në deklaratimet e të dëmtuarit M. N., por deklaratimet e të cilit sipas vlerësimit të gjykatës jo vetëm që janë kontradiktore me vetveten por edhe me provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor fillimisht ka analizuar dëshminë e të dëmtuarit M. N. i cili ka deklaruar se nga viti 2010 deri në vitin 2014, të akuzuarit për ta pajisur me certifikatë me pije alkoolike ja ka paguar nga 500,00 €, me përjashtim të vitit 2012, ku i ka paguar vetëm 300,00 € dhe ka konstatuar se pretendim i tillë i të dëmtuarit është vetëm deklarativ dhe i pa bazuar në asnjë provë apo dëshmi tjetër. Gjykata ka konstatuar se deklarimi i tillë i të dëmtuarit është i pa bazuar fillimisht për faktin se i dëmtuari ka theksuar se për vitin 2009-2010, e ka parë fletë pagesën, e cila ka qenë 500,00 €, i cili deklarim është në kundërshtim me faturën 00097, të datës 13.04.2010, ku saktësisht është e konstatuar se pagesa e kryer për certifikatën e alkoolit nga N.H.SH "E." me pronar M. N. për vitin 2010 është 200,00 €, e jo 500,00 €, ashtu siç ka theksuar i dëmtuari gjatë dëshmisë së tij. Po ashtu se deklarimi i të dëmtuarit është i pabazuar dhe argumentuar, gjykata e ka vërtetuar edhe nga fakti se i dëmtuari gjatë dëshmisë së tij fillimisht ka theksuar se me përjashtim të vitin 2009-2010, kur është përpiluar procesverbali nga inspektorët gjatë inspektimit, për vitet tjera nuk kanë përpiluar asnjë procesverbal dhe pasi të dëmtuarit i janë ofruar për shikim procesverbalet e inspektimit për vitet 2011, 2012 dhe 2013 ka pohuar se procesverbalet janë nënshkruar nga vëllai i tij L. N., andaj edhe mbi këtë bazë gjykata ka konstatuar se është e pabesueshme dëshmia e të dëmtuarit se ja ka paguar të akuzuarit nga 500,00 €, sepse asnjëherë nga viti 2011, 2012, 2013 kur i akuzuari së bashku me inspektorët tjerë ka qenë në inspektim i dëmtuari nuk ka qenë i pranishëm por i pranishëm ka qenë vëllai i tij .

Gjykata ka analizuar pretendimin e të dëmtuarit të dhënë gjatë dëshmisë së tij se për vitin 2013 pagesën e ka kryer vëllai i tij dhe ka konstatuar se ky pretendim i të dëmtuarit është në kundërshtim me provat tjera të administruara si me dëshminë e dëshmitarit G. R., si zyrtar kryesor financiar në Kuvendin e Komunës në Gjakovë, i cili gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 10.06.2015, ka theksuar se për vitin 2013 nga hotel "E." nuk është bërë asnjë pagesë, e po ashtu edhe nga kartela financiare e lëshuar nga Drejtoria e Inspeksionit është e konstatuar se për vitin 2013 N.H.SH."E.", nuk e ka bërë pagesën gjegjësisht pagesa nuk ekziston.

Pretendimet e të dëmtuarit se pagesat për certifikatat i ka bërë personalisht dhe kur i ka bërë pagesat brenda në lokalë ka qenë vetëm i akuzuari A. L., ndërsa inspektorët tjerë kanë qenë jashtë, ku e mban mend inspektoren H. L. dhe ka konstatuar se deklarimi i tillë i të dëmtuarit është në kundërshtim me dëshminë e dëshmitarëve H. Ll. dhe I. M. të cilit gjatë dëshmisë së tyre kanë theksuar se gjatë inspektimit janë ulur në një tavolinë së bashku brenda në lokal ku i pranishëm ka qenë vëllai i të dëmtuarit L. N. dhe jo i dëmtuari M., e po ashtu gjykata ka vërtetuar se dëshmia e këtyre dëshmitarëve përputhet edhe me procesverbalet e inspektimit, ku vet i dëmtuari M. N. ka theksuar se procesverbalet janë nënshkruar nga vëllai i tij.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e të akuzuarit të parashtruara gjatë mbrojtjes së tij, i cili ka theksuar se për vitet 2010 dhe 2011, N.H.SH.”E.” ka pasur të ndarë restorantin nga pjesa e hotelit dhe ky restorant ka qenë në madhësi më të vogël se 100 m2, andaj ka paguar 200,00 €, ndërsa për vitin 2012 ka paguar 300,00 €, pasi ka hap një sallë të re me madhësi më të madhe se 100 m2 dhe gjykata ka konstatuar se edhe me Rregulloren Komunale për Certifikimin e Punës me Pije Alkoolike, gjegjësisht me nenin 16 të kësaj Rregullore janë të parapara këto shuma të pagesave dhe për këto hapësira ashtu siç deklarohet edhe vet i akuzuari, e po ashtu se ky pretendim i të akuzuarit është i bazuar, gjykata e ka konstatuar edhe për faktin se ky pretendim përputhet edhe me vet deklarin e të dëmtuarit të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 10.06.2015, ku pas përfundimit të procedurës së provave dhe pyetjes së gjykatës se a kanë palët propozime tjera, i dëmtuari M. N. ka kërkuar fjalën dhe ka theksuar se është i vërtetë se operativa që nënkupton tavolina vetëm për kafe dhe pije alkoolike ku nuk ka ushqim, pasi salla e ushqimit gjendet në katin e dytë, janë të ndara nga sallat e dasmave dhe dhomat e hotelit, por edhe kur inspektorët e bëjnë kontrollin e bëjnë ndaras kontrollin e sallave të restorantit dhe dasmave dhe ka theksuar se të gjitha kontrollet janë bërë për restorantet e jo për sallat e dasmave dhe dhomat e hotelit.

Gjykata ka konstatuar se pretendimet e të akuzuarit sa i përket lartësisë së pagesave të paguara janë të bazuara edhe nga fakti se edhe nga dëshmia e dëshmitarit G. R. të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 10.06.2015, i cili pasi ka shikuar pagesat e kryera nga N.H.SH.”E.”, për certifikatën për shërbime me pije alkoolike për vitin 2010, 2011, 2012, ka deklaruar se këto pagesa janë të tërësishme-përfundimtare dhe se në zyrën e financave për vitet 2010, 2011 dhe 2012 nuk figurojnë se N.H.SH.”E.” ka ndonjë borxh sa i përket këtyre pagesave, e po ashtu gjykata ka konstatuar se deklarimi i të akuzuarit se N.H.SH “E.” për vitin 2013 nuk ka bërë pagesë për tu pajisur me këtë certifikatë, është e bazuar pasi që këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit G. R., i cili gjatë dëshmisë së tij ka theksuar se për vitin 2013, nuk është bërë asnjë pagesë si dhe nga kartela financiare e lëshuar nga Drejtoria për Inspeksion, ku është e konstatuar se N.H.SH “ E.” për vitin 2013 nuk ka bërë pagesë.

Gjykata nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor një nga një e pastaj të ndërlidhur njëra me tjetrën ka konstatuar se e vetmja provë me të cilën është bazuar prokuroria se i dëmtuari M. N. i ka paguar të akuzuarit para kesh për ta pajisur me certifikatën me shërbime me pije alkoolike e pastaj i akuzuari nuk e ka pajisur me këtë certifikatë është vetëm deklarata e të dëmtuarit, pasi me asnjë provë tjetër nuk është vërtetuar ky pretendim si dhe bazuar edhe në faktin se deklaratat e të dëmtuarit është kontradiktore jo vetëm me vetveten, por nuk përputhet dhe nuk është në harmoni me asnjërin nga provat tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor e bazuar edhe në faktin se sipas rregullores komunale dhe dëshmive të dëshmitarëve i akuzuari nuk ka pasur kompetencë për ta lëshuar këtë certifikatë, por kompetent është Drejtori i Drejtorisë për Punë Inspektuese, e bazuar në neni 262 par. 1 të KPP-së, ku është e përcaktuar se i pandehuri nuk mund të shpallet fajtor, duke u bazuar vetëm në një dëshmi, e në këtë rast deklaratën e të dëmtuarit, si dhe duke u bazuar në faktin se fajësia e të pandehuri ka mbetur në nivelin e dyshimit të arsyeshëm e jo të bazuar mirë, gjykata duke u bazuar në parimin In Dubio Pro Reo-në rast të dyshimit në favor të akuzuarit, bazuar në neni 364 par. 1, nën par. 1.3 të KPP-së, në mungesë të provave të akuzuarin A. L. e ka liruar nga akuza për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së, të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi që pala e dëmtuar të udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463 par. 3 të KPP-së.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës është marr bazuar në nenin 454 parag.1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
PKR. nr. 2/15 më datë 03.07.2015

Sekretarja Juridike
Mandushe Doli

Kryetari i Trupit Gjykues-gjyqtari
Nikollë Komani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.